

E drejta e informimit 2018 – Informacioni i vonuar është informacion i mohuar.



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**



SWEDEN

Informacioni
i vonuar
është
informacion
i mohuar

Më 28 Janar 2019, Res Publica prezantoi raportin për të drejtën e informimit gjatë vitit 2018. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga Civil Rights Defenders, me fonde të Mbreterisë së Suedisë, i cili konsiston në mundësimin e qytetarëve të aksesojnë informacionet publike, si dhe në berjen e një vlerësimi të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Një kermill (simboli i ngadalesisë) tërheq një dosje avash avash për ta sjellë të kerkuesi. Dosja megjithatë një ditë mberrin, ajo quhet se nuk ka ardhur kurrë (për atë kohë sa ishte i vlefshëm si informacion). Në këto metafore, raporti

solli shifra krahasuese me periudhat e meparshme (vitet 2015, 2016, 2017), per te vene re nese ka permiresime apo perkeqesime te treguesve. Ne thelb te diskutimit u shtrua pikerisht vonesa ne marrjen e informacionit, e cila dukshem eshte shtuar gjate vitit 2018. Afati i kthimit te pergjigjeve fillestare eshte rritur nga 13 ne 26 dite. Afati i reagimit pas ankimit administrativ eshte rritur nga 13 ne 25 dite. Vendimet e Komisionerit per te Drejten e Informimit merren per mesatarisht 54 dite. Nderkohe qe cilesia e vendimeve te Komisionerit eshte e mire, dinamika e trajtimit te rasteve ka lene per te deshiruar, duke sjelle si pasoje nje relaksim te institucioneve karshi detyrimeve sipas ligjit nr. 119/2014 "Per te drejten e informimit". Keto, por edhe gjetje te tjera qe flasin per problematika te vecanta, jane bere pjese e studimit te plote, te cilin [mund ta shkarkoni ketu](#).

Raport i permbledhur per zbatimin e ligjit per konsultimin publik 2017-2018



Me

mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit “*Promovimi i pjesmarrjes qytetare në advokimin legjislativ*”, Res Publica po vijon monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Për periudhën e deritanishme, 2017 – 2018, po publikojmë një raport të përmbledhur, në të cilin analizohen të dhënat që janë mbledhur deri në këtë periudhë dhe disa nga indikatorët mbi të cilat do të mbështetet dhe përgatitja e studimit përfundimtar në Mars 2019. [Për më shumë klikoni këtu për të shkarkuar raportin.](#)

Situata deri tani shfaqet problematike. Organet publike janë ende larg zbatimit në mënyrë efektive të ligjit dhe akteve nënligjore. Në vija të përgjithshme konstatohet që Ministrinë nuk i plotësojnë tabelat për njoftimin dhe konsultimin publik të projektakteve. Ministrinë nuk hartojnë dhe nuk publikojnë raportet vjetore të transparencës. Konstatohet që Bashkitë kanë mungesë informacioni dhe nuk kuptojnë kush janë aktet që përfshihen dhe janë subjekt i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, duke demonstruar nevojë urgjente për trajnime në këtë fushë. Regjistri për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është ende shumë larg funksionimit në mënyrë efektive, sepse nga njëra ana institucionet pothuaj nuk e përdorin këtë faqe dhe nga ana tjetër publiku nuk shfaq asnjë interes për këtë faqe.

Nga ana tjetër, cilësia e komenteve dhe rekomandimeve të ardhura nga publiku lë ende për të dëshiruar dhe pjesa më e madhe e grupeve të interesit nuk shfaqin rol aktiv në proceset vendimmarrëse edhe kur u jepet mundësia të marrin pjesë në to.

Të dhënat dhe gjetjet që do të rezultojnë në fund të këtij projekti, do të krahasohen me të dhënat e studimeve paraprake, me qëllim konstatimin se si organet publike zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe sa efektiv është ky ligj në duart e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit. Rekomandimet që do të dalin nga ky studim, do t'i vendosen në dispozicion institucioneve kompetente dhe aktorëve të fushës me qëllim marrjen e masave administrative si dhe për të bërë amendimet e nevojshme në ligj.

Res Publica

Efektiviteti i ligjit për të drejten e informimit – 2017

Tashme është bërë traditë që Res Publica në fund të çdo viti vlereson efektivitetin e ligjit për të drejten e informimit. Me mbështetjen e Civil Rights Defenders, sjellim një tablo kritike ndaj ligjit dhe mangesive të tij. Teorikisht ligji është renditur si i gjashti në botë për nga cilësia, por ky ligj nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për të garantuar transparencën e autoriteteve publike kur ato nuk kanë vullnet të japin informacionet e kërkuara.

Për më shumë [klikoni këtu për të shkarkuar raportin](#).

Res Publica

Indeksi i transparences 2017

Prej kohesh Res Publica angazhohet fuqimisht ne mbrojtjen e nje prej te drejtave themelore ne nje shoqeri demokratike – te drejtes per informim.

Ne kuader te projektit “Rritja e aksesit të gazetareve investigues në informacionin zyrtar” që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i

Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, Res Publica synon te sjelle nje tablo se si paraqitet transparenca e autoriteteve publike. Transparenca eshte vleresuar ne te dy aspektet, ate proaktive dhe ate reaktive.

Res Publica monitoroi 100 autoritetet publike më të rëndësishëm per permbushjen e programeve te transparences dhe vleresoi gjithashtu edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Janë dërguar gjithsej 515 kërkesa për informacion, prej të cilave 84 janë nga gazetarët investigues.

Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Vleresimi u be ne menyre dinamike duke studiuar ndryshimet cdo muaj gjate periudhes Shtator 2016 – Qershor 2017. Rezultatet mujore jane publikuar ne faqen www.pubbleaks.al dhe raporti i permbledhur pasqyron gjetjet kryesore te periudhes, shoqeruar me rekomandimet perkatese. Per me shume [klikoni ketu per te shkarkuar raportin](#).

Komentari i ligjit nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”

Nje nga risite ne legjislacionin e propozuar nga shoqeria civile ne vitin 2014 ishte edhe ligji nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”. Ligji synon te perfshije qytetaret ne vendimmarrje duke marre prej tyre rekomandime permes nje procesi kompleks ku autoritetet shteterore qe draftojne ligje, politika e strategji, duhet se pari te konsultohen me publikun.

Megjense ky ligj eshte nje mjet i ri ne duart e publikut ne pergjithesi dhe shoqerise civile ne vecanti, Res Publica, me mbeshtetjen e National Endowment for Democracy, eshte perpjekur ta beje sa me te kuptueshem ligjin permes nje komentari, ne menyre qe ai te perdoret sa me gjeresisht per rezultate sa me efektive.

Per me shume [klikoni ketu per te shkarkuar komentarin](#). Lexim te kendshem.

E drejta e informimit 2016 – Studim krahasues

Tashme kane kaluar dy vjet qe nga hyrja ne fuqi e ligji te ri per te drejten e informimit (119/2014). Ligji erdhi si nje risi teper e rendesishme, duke synuar rritjen e transparences se qeverise dhe marrjen e informacionit shume me shpejt.

Por si ka funksionuar ky ligj ne praktike gjate vitit te dyte? Si eshte situata ne krahasim me vitin e pare pas miratimit? Cfare eshte permiresuar dhe cfare nuk shkon mire? A ka nevoje ky ligj per amendamente dhe nese po, ku duhet nderhyre?

Qendra Res Publica, me mbeshtetjen e Civil Rights Defenders, gjate vitit 2016 ka bere nje testim te ligjit per te drejten e informimit ne shume menyra dhe gjetjet e rekomandimet jane permbledhur ne publikimin me titull “E drejta e informimit 2016”. Pas prezantimit te tij me 16 Dhjetor 2016, Res Publica ve ne dispozicion nje kopje elektronike te studimit [\(kliko ketu per ta shkarkuar\)](#).

Res Publica

Konsultimi publik – Sfidat e vitit te pare te zbatimit te ligjit

Ne kuader te nje projekti te mbeshtetur nga National Endowment for Democracy, Res Publica ka ndermarre nje studim per efektivitetin e ligjit nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe

konsultimin publik". Studimi u krye permes nje monitorimi te aurotiteteve shteterore kryesore qe marrin nisma legjislative.

Ne fokus u vu edhe vete ligji ne menyren se si eshte ndertuar, duke bere nje analize krahasuese me standardet nderkombetare ne kete fushe. Gjate periudhes se monitorimit Res Publica kreu edhe disa testimet qe vune ne dukje probleme ne ligj, te tilla qe duhen te adresohen nga legjislatori. Ne perfundim te materialit jepen edhe rekomandimet perkatese. Per me shume [klikoni ne kete link](#).

E drejta e informimit ne bankoprove

Ligji i ri per te drejten e informimit, i miratuar ne fund te vitit 2014, erdhi si nje risi teper e rendesishme, duke synuar rritjen e transparences se qeverise dhe marrjen e informacionit shume me shpejt.

Por, a funksionon kaq mire ky ligj? Si ka funksionuar ai ne praktike gjate vitit te pare pas miratimit? Cilet problemesh jane hasur gjate vitit te pare? A ka nevojte nje ligj kaq i ri per amendamente dhe nese po, ku duhet nderhyre? Cilet jane autoritetet qe e zbatojne dhe cilet e shperfillin?

Qendra Res Publica, me mbeshtetjen e Civil Rights Defenders, gjate vitit 2015 ka bere nje testim te ligjit te ri ne shume menyra dhe gjetjet e rekomandimet jane permbledhur ne publikimin me titull "E drejta e informimit ne bankoprove". Pas prezantimit te tij me 4 Dhjetor 2015, Res Publica ka vene ne dispozicion te cdo personi te interesuar nje kopje elektronike te raportit [\(kliko ketu\)](#).

Diskutim për të drejtën e informimit dhe dekriminalizimin e shpifjes

Qendra Res Publica me mbështetjen e South East European Media Observatory dhe të partnerit Instituti Shqiptar i Medias, në datën 30.09.2014 organizoi tryezën me temë diskutimi: “Nxitja e ushtrimit të të drejtës së informimit dhe dekriminalizimi i shpifjes”. Në këtë takim morën pjesë gazetarë, juristë, përfaqësues të organiztave të ndryshme të shoqërisë civile, të cilët diskutuan rreth problemeve që kishte ligji i mëparshëm për të drejtën e informimit, risitë që ka ligji i ri për të drejtën e informimit, i cili është miratuar nga parlamenti dhe pritet të hyjë në fuqi. Gjithashtu u diskutua rreth problemeve që hasin gazetarët kur publikojnë lajme apo opinione, të cilat përmbajnë fakte për funksionarët publikë dhe riskut me të cilin ata përballe nëse kallzohen penalisht për shpifje. Cili është impakti që ka vepra penale e shpifjes, a ekziston domosdoshmëria që shpifja të përbëjë vepër penale, apo është e mjaftueshme përdorimi i padisë civile, kur pretendohet se është cënuar reputacioni, dinjiteti, personaliteti i një funksionari public, ishin disa nga pikpyetjet që u ngritën në takim.

Për të sqaruar cilat ishin shkaqet dhe arsyet për miratimin e një ligji të ri “Për të drejtën e informimit” në takim ishte i pranishëm Z. Genti Ibrahimi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Studime Publike dhe Ligjore, i cili ka dhënë një kontribut të madh në hartimin e ligjit të ri. Z.Ibrahimi shpjegoi në

parim disa nga avantazhet e ligjit në parim dhe theksoi se përgatitja e një komentari që në momentin e hyrjes në fuqi të një ligji merr rëndësi të veçantë për të fiksuar që në fillim piketat e zbatimit të tij.

Një interpretim i detajuar i ligjit të ri për të drejtën e informimit, u prezantua nga Z. Dorian Matlija, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Res Publica.

Një panoramë të përgjithshme mbi standartet ndërkombëtare dhe arsyet e dekriminalizimit të shpifjes u prezantuan nga Z.Theodoros Alexandridis, Ekspert për jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në fund të këtij takimi Res Publica prezantoi Komentarin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kopje të të cilit iu shpërndanë pjesmarrësve në takim.

Mirëpresim kërkesa nga çdo person i interesuar për tu pajisur me një kopje të këtij komentari.

Res Publica

Ligji i ri për të drejtën e informimit – një armë e fuqishme në duart e publikut

Informacioni është një nga indikatorët më të rëndësishëm për të përcaktuar nëse një shoqëri është demokratike ose jo. Midis dy palëve, qeverisë nga njëra anë dhe publikut nga ana tjetër, ka vazhdimisht një përpjekje të kërkuar informacion por edhe për t’ia fshehur atë prej njeri-tjetrit. Qeveria është gjithmonë në pozita më të privilegjuara, ndërsa publiku është

palë më e dobët, sidomos në shoqëritë jodemokratike. Në një shoqëri demokratike askush nuk është i privilegjuar, por ekziston një balancë midis dhënies dhe kufizimit të informacioneve nga të dy palët. Themi të dy palët, sepse jo vetëm publiku është i interesuar të marrë informacione mbi veprimtarinë e qeverisë, por edhe kjo e fundit është e interesuar të marrë informacion rreth veprimtarisë private të individëve për të parandaluar apo ndëshkuar krimet dhe kundravajtjet. Të dyja ecin paralelisht. Nëse qeveria ngushton hapësirën private të individëve ajo është e detyruar ti përgjigjet në të njëjtin nivel edhe kërkesës për hapjen e saj. Për shembull, së fundi qeveria kërkoi të merrte informacion për numrat IMEI, duke e shtyrë kufirin pak më tutje dhe ngushtuar privatësinë e qytetarëve dhe kjo u justifikua me interesin publik. I njëjti interes justifikon edhe kërkesën e publikut për të shtyrë më tutje kufirin e mbrojtjes së informacioneve zyrtare. Nëse qeveria kërkon të dijë më shumë rreth nesh, edhe ne duhet të dimë më shumë rreth saj.

Zhvillimet e fundit kanë qenë më pozitive për publikun sesa për qeverinë. Ndërkohë që në Gjykatën Kushtetuese diskutohet kushtetueshmëria e zbulimit të numrave IMEI dhe mundësia e përgjimit prej kësaj manovre, nga ana tjetër, më 18 shtator Kuvendi miratoi një ligj të ri për të drejtën e informimit që zbulon veprimtarinë shtetërore në përmasa shumë të mëdha se më parë.

Është e vërtetë që edhe më parë e drejta e informimit nuk ishte një koncept i panjohur për publikun shqiptar. Shqipëria aktualisht vjen pas një historie të një ligji të miratuar që në vitin 1999 (nr. 8503), i cili qendroi në fuqi për 15 vjet. Por zbatimi i këtij ligji, të lënë pas tashmë, ka qenë sporadik dhe i shoqëruar me shumë probleme, që e kanë bërë ligjin praktikisht të pazbatueshëm. Ai ishte shumë larg standardeve të kohës. Kishte mangësi që shkaktonin probleme në interpretimin e tij, afatet ishin të stërzgjatur dhe të paleverdisshëm, mungonte një mënyrë efektive për të penalizuar

zyrtarët që refuzonin informacionin pa shkak, nuk jepej asnjë lloj ndihme nga shteti dhe mbi të gjitha nuk kishte asnjë skemë proaktive që qeveria të publikonte vetë informacionet më të rëndësishme pa u paraqitur ndonjë kërkesë nga ndokush.

Arsyet e mësipërme e bënë të pashmangshme nevojën për diskutimin e një drafti të ri, të cilin e propozoi shoqëria civile (me nismën e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë) dhe që mazhoranca aktuale e pa të arsyeshme të mos rezistojë dhe të përkrahë këtë nevojë të shoqërisë, aq më tepër kur ligji synon të dëmtojë keqbërësit e veshur me funksione shtetërore dhe jo vetë funksionimin e shtetit.

Megjithëse në këto dy dekada kemi përjetuar një revolucion të legjislacionit në shumë fusha, liria e informimit e gjeti me shumë vështirësi rrugën drejt efektivitetit. Lobimi mes shoqërisë civile dhe qeverive të ndryshme zgjati për shumë vjet pa ndërprerje për të arritur në fund që sot të kemi një armë të fuqishme në dorë për të kuptuar si funksionon shteti, për të përfituar shërbime më të mira publike dhe mbi të gjitha për të ushtruar trysninë e kërimit të llogarisë nga funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar.

Ligji i ri, ndonëse duket fillimisht si i bazuar në modelin paternalist të qeverisë së hapur, me në qendër qeverinë që vendos se çfarë duhet të dime, ka përfshirë gjerësisht edhe lirinë e informimit. Duke zgjeruar hapësirën e lirisë së informimit skemat proaktive të botimit nuk krijojnë varësi, por vijnë në ndihmë. Shumë informacione nga ato që zakonisht kërkohen nga gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile apo individë të tjerë të interesuar, tashmë do të jenë të aksesueshëm online për t'u arritur pa kosto, me komoditetin e një kliku. Informacionet e tjerë mund të kërkohen me një shkresë të thjeshtë apo edhe me email dhe për 10 ditë pune mund të kemi në dorë cdo gjë që duam të dimë. Përjashtime do të ketë vetëm për dokumentat e klasifikuara sekret shtetëror (publikimi i tyre mund të dëmtojë interesat kombëtare), proceset hetimore (publikimi i detajeve mund të dëmtojë

hetimet), si dhe të dhënat personale ose sekretet tregtare (publikimi i tyre mund të dëmtojë interesa personale). Por, në rast se ka një interes publik më të lartë edhe këto informacione do të mund të aksesohen. Për shembull një gazetar investigativ i cili synon të zbulojë një aferë korruptive do të ketë më shumë mundësi të zbulojë informacione të këtij karakteri, pasi ai nuk e kërkon informacionin vetëm për interesin e tij personal, por për t'i shërbyer interesit publik të ndëshkimit të fajtorëve.

Me anën e krijimit të një organi të ri vendimmarrës (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) do të bëhet e mundur që ligji të pasurohet me praktika të unifikuara që do të plotësojnë boshllëqet, sidomos përmes provokimit të rasteve nga OJF të specializuara.

Me një hap mjaft cilësor përpara, ligji i ri parashikon një sërë rregullash favorizuese, që në ndryshim nga ligji i mëparshëm, i japin mundësinë që ai të kthehet në një ligj praktik dhe të vlefshëm. Kështu mund të përmendim afatet e shkurtra (10 ditë pune), ekzistencën e një organi që shqyrton ankesat (që deri më parë nuk ekzistonte), sanksionet e ashpra për zyrtarët që refuzojnë dhënien e informacionit, mundësinë e konsultimit të dokumenteve në vend, rishikimi i klasifikimit të dokumentave secret, programet e transparencës që do të publikojnë online pjesën dërrmuese të informacioneve që zakonisht kërkon publiku, etj.

Aksesi në informacion dhe në dokumenta nuk do të prekë vetëm qeverinë në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe pushtetin legjislativ, gjykatat e prokuroritë e cdo niveli. I gjithë shteti është tashmë më i zbuluar dhe kushdo që do të përpiqet ta pengojë informacionin do të përballlet me gjoba të njëpasnjëshme deri sa ta mos i leverdisë askujt të mbajë një kosto kaq të madhe personale dhe t'ia dorëzojë të vërtetën në dorë publikut, sado e dhimbshme qoftë ajo.

Është veçanërisht një domosdoshmëri që shoqëria civile dhe gazetarët të ushtrojnë sa më shumë të drejtat e fituara nga ky ligj i ri, në mënyrë që të evidentohen të gjitha problemet që pa një test të mirëfilltë praktik nuk mund të merren me mend në mënyrë teorike. Në mënyrë teorike presupozohet që vullneti i autoriteteve dhe aftësia e tyre për zbatimin e ligjit të jenë në nivele të kënaqshëm. Prezupozohet gjithashtu edhe funksionimi i mirë i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Por praktika do të jetë testi më i mirë.

Ligji ka krijuar hapësira për të siguruar një transparencë që deri më parë nuk ishte imagjinuar. Është në interesin e të gjithë shoqërisë që ky ligj të kthehet në shembullin më të mirë të armës së dhuruar publikut për të luftuar pikërisht fabrikuesin e vet, me qëllim pastrimin e tij nga çdo qelizë e korruptuar.

Një epokë e re ka nisur, një epokë kur qeveria është më transparente se kurrë më parë. E vetmja gjë që na duhet të bëjmë është të bëjmë sa më shumë pyetje dhe të mos mbetemi pasivë, në varësinë e atij versioni fakteve që serviret nga zëdhënësit. E vërteta nuk ka nevojë për zëdhënës, ajo bërtet vetë kur e rrëmben dhe e sheh në sy.

Dorian Matlija

Res Publica